

Uppgifter B

Textpaket

Litteracitet

1

Steg 2

3

Elever som läser och skriver





Innehåll

Inledning	3
------------------------	----------

Textpaket 1

Lejonet och räven.....	5
En karta över en ö.....	7
Skorpionen	9

Textpaket 2

Skorpionen	12
Den giriga mannen.....	14
Potatischips	16

Textpaket 3

Skorpionen	19
Potatischips	21
Sömn.....	23
Mjölk	25
Världens städer	27

Litteratur- och bildförteckning	29
--	-----------



Inledning

Detta häfte innehåller underlag för *Uppgifter B – Textpaket*. Uppgifterna använder du tillsammans med *Samtals- och dokumentationsunderlag B* och *Bedömningsunderlag för Uppgifter B*.

Instruktionerna för hur du genomför uppgifterna finns i *Samtals- och dokumentationsunderlag B*.

Dokumentera elevens svar på uppgifterna i bedömningsunderlagen. Var uppmärksam på att svarsrutorna för ”Ja” och ”Nej” kommer i en annan ordning på elevens svarsblad när språket har läsriktningen höger–vänster.

Varje uppgift består av två blad – en text och elevens svarsblad med läsförståelsefrågor. Information om hur du väljer uppgifter till eleven finns i lärarhandledningen (se s. 6–7). Skriv ut uppgifterna i färg och enkelsidigt så att eleven kan se texten och frågorna samtidigt.

Se gärna tolken kopior av uppgifterna du har valt, både på svenska och på elevens språk.

Om översättningen

Översättningen använder det enligt lag (1998) nationella standard- och undervisningsspråket i Albanien. Standarden bygger på dialekten tosk, som har varit utgångspunkt för det nationella språket i Albanien sedan 1952. En annan variant av albanska, som dock är baserad på dialekten gheg, används i Kosovo som de facto officiellt språk, samt i Montenegro (Crna Gora) och Makedonien, där albanska enligt lag (2007 resp. 1991) är ett regionalt språk. Personer från dessa områden kan därför uppleva att det finns skillnader i språkbruk och ordförråd i kartläggningsmaterialet jämfört med det egna språkbruket.

Anpassning av uppgifter för elever med funktionsnedsättning

Om du läser upp eller spelar in uppgifter för elever med svår synnedsättning behöver du anpassa uppgifter som innehåller bilder eller figurer. Kontakta en speciallärare eller specialpedagog om det behövs.

Textpaket 1

- Text 1. Lejonet och räven. Beskriv innehållet i bilden.
- Text 2. En karta över en ö. Uppgiften stryks.
- Text 3. Skorpionen. Beskriv skorpionen i bilden. (Ingår även i textpaket 2 och 3)

Textpaket 2

- Text 3. Potatischips. Använd riktiga potatischips. (Ingår även i textpaket 3)

Textpaket 3

- Text 3. Sömn. Figuren kan strykas. Frågorna 3 och 4 som bygger på information i figuren stryks.
- Text 5. Världens städer. Diagrammet kan strykas. Frågorna 2 och 4 som bygger på information i diagrammet stryks.

Läs mer i *Anpassning för elever med funktionsnedsättning*.

Textpaket 1



Luani dhe dhelpra

Luani ishte shtrirë në shpellën e vet.

Ai rrinte i shtrirë aty, ditën dhe natën.

Dëgjoheshin vetëm ulërime të vogla e të molisura nga ai.

– Ai është i sëmurë, menduan shtazët, dhe ju vinte keq për të.

Ata filluan të hynë në shpellën e luanit me dhurata të vogla.

Por, dhelpra nuk hynte brenda.

Luani e pyeti me zë të butë:

– Pse nuk vjen ti, miku im? Të gjithë të tjerët kanë qenë këtu.

– Unë mendoja të vi, tha dhelpra, por unë pashë gjurmët e këmbëve dhe u frikësova. Të gjitha gjurmët hynin brenda në shpellën tënde, por asnjë gjurmë nuk dilte nga shpella. Prandaj mendova të rri jashtë.



Pyetjet për "Luanin dhe dhelpren"


Përgjigju Po ose Jo në këto pyetje për tekst.

- | | Po | Jo |
|--|--------------------------|--------------------------|
| 1. A ishte luani në shpellën e vet gjithë kohën? | ☐ | ☐ |
| 2. A hyri dhelpra brenda te luani? | ☐ | ☐ |
| 3. A i dha dhelpra luanit dhurata? | ☐ | ☐ |
| 4. A i kishte ngrënë luani shtazët e tjera? | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

5. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
6. A beson ti se luani ishte i sëmurë? A mund të tregosh, si mendon atëherë?
7. A ishte dhelpra më e zgjuar se sa shtazët e tjera? A mund të tregosh, si mendon atëherë?
8. A beson se mund të mësosh diçka nga ky tregim? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Një hartë e një ishulli



Pyetje për "Një hartë e një ishulli"

Vë një kryq në katror për atë përgjigje që ti mendon se është e saktë. Ti mund të vësh, vetëm një kryq.

1. Cili nga këto vende shtrihet më afër portit?

- A ☐ Qyteti
B ☐ Liqeni
C ☐ Çifligu

2. Cili nga këto vende shtrihet në veri të qytetit?

- A ☐ Aeroporti
B ☐ Pylli
C ☐ Çifligu

3. Nëse shkon nga qyteti për te liqeni, në cilin drejtim do të shkosh?

- A ☐ Veri
B ☐ Perëndim
C ☐ Lindje

4. Mendoje se ke dalë të shëtisësh në ishull. Ndjek udhëzimet.

1. Fillo në fshat.
2. Ndjeke rrugën për te porti.
3. Kthehu majtas në udhëkryqin e dytë.
4. Vazhdo derisa të mbaroj rruga.
5. Ku je ti tani?

- A ☐ Çifligu
B ☐ Qyteti
C ☐ Porti

Akrepi – shtazë merimangë me thumb

Nuk është ndonjë ide e mirë të shkosh dhe të prekësh me gishta në vrima të vogla në mure dhe në mes të gurëve, në zonat e ngrohta. Duhet, po ashtu, t'i shkundësh këpucët, nëse ato kanë qëndruar një çast të gjatë, pa i mbath ato. Ato, ndoshta nuk janë më fare të zbrazëta. Sepse akrepit nuk i pëlqen drita, por rri gjatë ditës dhe ngjeshët në vrima dhe në hapësira të tjera të errëta. Akrepat jetojnë në vendet e ngrohta, në gjithë botën, por rrallëherë i shohim ata.

Pickon për vdekje prenë e vet

Akrepat mund të jenë shumë helmues, edhe pse shumica e llojeve, nuk janë vdekjeprurëse për njerëzit. Ata bëhen nga një deri në njëzetë centimetra të gjatë, varësisht se cili lloj është, por të gjithë e kanë një thumb helmues në maje të bishtit. Kur një akrep do të mbys një pre, e lakon lartë bishtin mbi shpinë dhe e pickon prenë, të cilën e mban me kthetrat. Një akrep i frikësuar rrotullohet shpejtë, që tërë kohën të drejtoj thumbin kah armiku.

Akrepi gjuan natën, merimanga të mëdha dhe kandrra të tjera të vogla. Ata kërkojnë me kthetrat, e kapinë prenë e tyre dhe e mbysin me thumbin helmues.



Akrepi

Pyetje për "Akrepin"

Përgjigju Po ose Jo në këto pyetje për tekstin.

- | | Po | Jo |
|--|--------------------------|--------------------------|
| 1. A i pëlqen akrepit terri? | ☐ | ☐ |
| 2. A munden të gjithë akrepat të mbysin njerëzit? | ☐ | ☐ |
| 3. A janë të gjitha llojet e akrepave njësoj të mëdhenj? | ☐ | ☐ |
| 4. A e gjuan akrepi prenë e vet me kthetrat? | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

5. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
6. Në tekstin për akrepin thuhet se duhet shkundur këpucët. Pse beson ti se duhet të bësh këtë? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Textpaket 2



Akrepi – shtazë merimangë me thumb

Nuk është ndonjë ide e mirë të shkosh dhe të prekësh me gishta në vrima të vogla në mure dhe në mes të gurëve, në zonat e ngrohta. Duhet, po ashtu, t'i shkundësh këpucët, nëse ato kanë qëndruar një çast të gjatë, pa i mbath ato. Ato, ndoshta nuk janë më fare të zbrazëta. Sepse akrepit nuk i pëlqen drita, por rri gjatë ditës dhe ngjeshët në vrima dhe në hapësira të tjera të errëta. Akrepat jetojnë në vendet e ngrohta, në gjithë botën, por rrallëherë i shohim ata.

Pickon për vdekje prenë e vet

Akrepat mund të jenë shumë helmues, edhe pse shumica e llojeve, nuk janë vdekjeprurëse për njerëzit. Ata bëhen nga një deri në njëzetë centimetra të gjatë, varësisht se cili lloj është, por të gjithë e kanë një thumb helmues në maje të bishtit. Kur një akrep do të mbys një pre, e lakon lartë bishtin mbi shpinë dhe e pickon prenë, të cilën e mban me kthetrat. Një akrep i frikësuar rrotullohet shpejtë, që tërë kohën të drejtoj thumbin kah armiku.

Akrepi gjuan natën, merimanga të mëdha dhe kandrra të tjera të vogla. Ata kërkojnë me kthetrat, e kapinë prenë e tyre dhe e mbysin me thumbin helmues.



Akrepi

Pyetje për "Akrepin"

Përgjigju Po ose Jo në këto pyetje për tekstin.

- | | Po | Jo |
|--|--------------------------|--------------------------|
| 1. A i pëlqen akrepit terri? | ☐ | ☐ |
| 2. A munden të gjithë akrepat të mbysin njerëzit? | ☐ | ☐ |
| 3. A janë të gjitha llojet e akrepave njësoj të mëdhenj? | ☐ | ☐ |
| 4. A e gjuan akrepi prenë e vet me kthetrat? | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

5. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
6. Në tekstin për akrepin thuhet se duhet shkundur këpucët. Pse beson ti se duhet të bësh këtë? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Njeriu koprrac

Një njeri koprrac shiti gjithçka që kishte dhe i shkriu paratë e floririt në një xhungë të madhe. Xhungën e floririt e groposi në kopshtin e tij, tek rrënjët e një druri. Ai, çdo ditë e vizitonte drurin. Një ditë e pa njëri nga fqinjët atë dhe e kuptoi menjëherë se çka po bënte. Kur njeriu koprrac kishte shkuar, fqinja e shfrytëzoj rastin të gërmoj e të nxjerr xhungën e floririt dhe e mori atë me vete.

Kur njeriu koprrac erdhi ditën tjetër për të parë thesarin e vet, e gjeti një gropë. Atëherë ai filloj të qaj dhe t'i shkul flokët nga trishtimi. Një mik, që rastësisht kaloi pranë, e pyeti se çka po ndodhë. Njeriu koprrac i tregoi se çka kishte ndodhur.

– O, a nuk ishte diçka tjetër, i tha miku, atëherë s'ke pse të jesh i mërzitur. Se floriri në realitet nuk ishte kurrë vërtet i yti. Merre një gur, dhe në vend të saj, vendose atë në gropë dhe merre me mend se ajo është xhunga e floririt! Ti do të kesh të njëjtin gëzim dhe dobi nga ai.

Pyetje për "Njeriun koprrac"

Vë një kryq në katror për atë përgjigje që ti e beson se është e saktë. Ti mund të vësh vetëm një kryq.

1. Ku e mori njeriu koprrac xhungën e floririt?

- A ☐ Ai e bleu atë nga fqinja.
B ☐ Ai e krijoi atë nga paratë.
C ☐ Ai e gjeti atë në kopsht.

2. Pse shkonte njeriu koprrac te druri, çdo ditë?

- A ☐ Për të groposur, edhe më shumë flori.
B ☐ Për të gërmuar dhe nxjerr floririn e tij.
C ☐ Për të ruajtur floririn e tij.

3. Çka mund të mësosh nga tregimi?

- A ☐ Se duhet të ndash pasurinë me të tjerët.
B ☐ Se e gëzon vetëm atë pasuri që e përdor.
C ☐ Se gjithmonë duhet t'i dëgjosh fqinjët dhe miqtë e tu.

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

4. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
5. Pse beson ti se njeriu koprrac shiti gjithçka kishte?
A mund të tregosh, si mendon atëherë?
6. Pse mendonte miku se, ai me dëshirë, mund të groposte një gur në gropë?
A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Çipset

Çipset janë feta patatesh të fërguara dhe ato i përkasin zbulimeve më të diskutuara të shekullit 18-të. Ka shumë histori, se kush i zbuloi dhe kush filloj t'i shes ato dhe është gati e pamundur të vendoset, nëse ndonjëra nga këto histori, përmban ndonjë të vërtetë.



Çipset

Historia më e përhapur flet për kuzhinierin George Crum. Më 24 gusht 1853, Crum u përpoq të kënaq një klient të pakënaqur. Ai preu feta të holla patatesh, ato i pjeku dhe rezultatin e kriposi dhe si rrjedhojë klienti u bë, nga një klient i pakënaqur në një klient shumë të kënaqur. Historia, edhe mund të jetë e vërtetë, por është e qartë, se edhe kuzhinierë të tjerë, arritën në ide të ngjashme, gjatë atij shekulli. Vetëm në SHBA, përmenden histori të ngjashme, në disa libra të kuzhinës dhe variante të tjera u zhvilluan në Britaninë e Madhe.

Për herë të parë, filluan të ofrojnë çipset për shitje në shitoret ushqimore në vitet 1890 dhe rritja e vërtetë e prodhimit dhe e shitjes së çipseve, filloj pas zbulimit të tiganit fërgues, i cili e lehtësoi gatimin, në fund të viteve 1920. Gjatë dekadës në vazhdim, përveç kësaj, ndryshoj edhe paketimi, ashtu që çipset mund të shpërndaheshin edhe në largësi të mëdha në SHBA. Sa i përket Evropës, shtrirja e çipseve në shitore vonoj, deri në vitet 1950.

Pyetje për "Çipset"

Vë një kryq në katror për atë përgjigje që ti beson se është e saktë. Ti mund të vësh, vetëm një kryq.

1. Pse e ka shkruar shkrimtari këtë tekst?

- A ☐ Për të informuar lexuesin mbi historinë e çipseve.
B ☐ Për të argëtuar lexuesin me një histori dëfryese.
C ☐ Për të udhëzuar lexuesin se si gatuhet çipset.

2. A dihet se kush i zbuloi çipset?

- A ☐ Po, ishte George Crum.
B ☐ Jo, ka më shumë persona të mundshëm.
C ☐ Jo, por dihet se *ku* u zbuluan.

Cilat thënie përputhen me atë që shkruhet për çipset në tekst?

Vë një kryq në katror me Po ose Jo, pas secilës thënie.

- | | Po | Jo |
|---|--------------------------|--------------------------|
| 3. Ne e dimë, përafërsisht, që sa kohë kemi ngrënë çipse. | ☐ | ☐ |
| 4. Evropa, ishte kontinenti i parë i botës, ku u shitën çipset. | ☐ | ☐ |
| 5. Kishte më shumë se një arsye, pse filluam me ngrënë më shumë çipse, gjatë shekullit 19-të. | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

6. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?

Textpaket 3



Akrepi – shtazë merimangë me thumb

Nuk është ndonjë ide e mirë të shkosh dhe të prekësh me gishta në vrima të vogla në mure dhe në mes të gurëve, në zonat e ngrohta. Duhet, po ashtu, t'i shkundësh këpucët, nëse ato kanë qëndruar një çast të gjatë, pa i mbath ato. Ato, ndoshta nuk janë më fare të zbrazëta. Sepse akrepit nuk i pëlqen drita, por rri gjatë ditës dhe ngjeshët në vrima dhe në hapësira të tjera të errëta. Akrepat jetojnë në vendet e ngrohta, në gjithë botën, por rrallëherë i shohim ata.

Pickon për vdekje prenë e vet

Akrepat mund të jenë shumë helmues, edhe pse shumica e llojeve, nuk janë vdekjeprurëse për njerëzit. Ata bëhen nga një deri në njëzetë centimetra të gjatë, varësisht se cili lloj është, por të gjithë e kanë një thumb helmues në maje të bishtit. Kur një akrep do të mbys një pre, e lakon lartë bishtin mbi shpinë dhe e pickon prenë, të cilën e mban me kthetrat. Një akrep i frikësuar rrotullohet shpejtë, që tërë kohën të drejtoj thumbin kah armiku.

Akrepi gjuan natën, merimanga të mëdha dhe kandrra të tjera të vogla. Ata kërkojnë me kthetrat, e kapinë prenë e tyre dhe e mbysin me thumbin helmues.



Akrepi

Pyetje për "Akrepin"

Përgjigju Po ose Jo në këto pyetje për tekstin.

- | | Po | Jo |
|--|--------------------------|--------------------------|
| 1. A i pëlqen akrepit terri? | ☐ | ☐ |
| 2. A munden të gjithë akrepat të mbysin njerëzit? | ☐ | ☐ |
| 3. A janë të gjitha llojet e akrepave njësoj të mëdhenj? | ☐ | ☐ |
| 4. A e gjuan akrepi prenë e vet me kthetrat? | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

5. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
6. Në tekstin për akrepin thuhet se duhet shkundur këpucët. Pse beson ti se duhet të bësh këtë? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Çipset

Çipset janë feta patatesh të fërguara dhe ato i përkasin zbulimeve më të diskutuara të shekullit 18-të. Ka shumë histori, se kush i zbuloi dhe kush filloj t'i shes ato dhe është gati e pamundur të vendoset, nëse ndonjëra nga këto histori, përmban ndonjë të vërtetë.



Çipset

Historia më e përhapur flet për kuzhinierin George Crum. Më 24 gusht 1853, Crum u përpoq të kënaq një klient të pakënaqur. Ai preu feta të holla patatesh, ato i pjeku dhe rezultatin e kriposi dhe si rrjedhojë klienti u bë, nga një klient i pakënaqur në një klient shumë të kënaqur. Historia, edhe mund të jetë e vërtetë, por është e qartë, se edhe kuzhinierë të tjerë, arritën në ide të ngjashme, gjatë atij shekulli. Vetëm në SHBA, përmenden histori të ngjashme, në disa libra të kuzhinës dhe variante të tjera u zhvilluan në Britaninë e Madhe.

Për herë të parë, filluan të ofrojnë çipset për shitje në shitoret ushqimore në vitet 1890 dhe rritja e vërtetë e prodhimit dhe e shitjes së çipseve, filloj pas zbulimit të tiganit fërgues, i cili e lehtësoi gatimin, në fund të viteve 1920. Gjatë dekadës në vazhdim, përveç kësaj, ndryshoj edhe paketimi, ashtu që çipset mund të shpërndaheshin edhe në largësi të mëdha në SHBA. Sa i përket Evropës, shtrirja e çipseve në shitore vonoj, deri në vitet 1950.

Pyetje për "Çipset"

Vë një kryq në katror për atë përgjigje që ti beson se është e saktë. Ti mund të vësh, vetëm një kryq.

1. Pse e ka shkruar shkrimtari këtë tekst?

- A ☐ Për të informuar lexuesin mbi historinë e çipseve.
B ☐ Për të argëtuar lexuesin me një histori dëfryese.
C ☐ Për të udhëzuar lexuesin se si gatuhet çipset.

2. A dihet se kush i zbuloi çipset?

- A ☐ Po, ishte George Crum.
B ☐ Jo, ka më shumë persona të mundshëm.
C ☐ Jo, por dihet se *ku* u zbuluan.

Cilat thënie përputhen me atë që shkruhet për çipset në tekst?

Vë një kryq në katror me Po ose Jo, pas secilës thënie.

- | | Po | Jo |
|---|--------------------------|--------------------------|
| 3. Ne e dimë, përafërsisht, që sa kohë kemi ngrënë çipse. | ☐ | ☐ |
| 4. Evropa, ishte kontinenti i parë i botës, ku u shitën çipset. | ☐ | ☐ |
| 5. Kishte më shumë se një arsye, pse filluam me ngrënë më shumë çipse, gjatë shekullit 19-të. | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

6. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?

Gjumi

Të gjithë kanë nevojë të flenë, si njerëzit ashtu edhe shtazët. Po, pse? As hulumtuesit nuk kanë përgjigje për këtë. Apo, çfarë ndodhë kur ne flemë. Por, që ne kemi nevojë të flemë – për këtë nuk ka asnjë dyshim. Pa gjumë vdesim.


Gjumi është një lloj pushimi. Edhe pse, ti nuk e vëren se çka ndodhë rreth e përqark teje. Në njëfarë mënyre mund të thuhet, se ti je i alivanosur kur fle. Por, jo aq thellë, sa që të mos mund të zgjohesh.

Cikli i gjumit

Gjumi bëhet në cikle të përsëritura, të cilat janë përafërsisht 90 minuta të gjata. Çdo cikël i gjumit përbëhet nga pesë faza, shih diagramin për ciklin e gjumit.

Gjumë ëndrrash dhe gjumë i thellë

Faza e pestë quhet gjumë ëndrrash. Sytë atëherë lëvizin shpejtë dhe është atëherë në ëndërrojmë. Gjumi i ëndrrave është sipërfaqësor, kjo do të thotë, se ne nuk flemë thellë. Gjumi i ëndrrave përsëritet çdo 90 minuta dhe ky vazhdon afërsisht, një të katërtën e periudhës tonë të gjumit. Një fazë tjetër, është gjumi i thellë. Është atëherë kur trupi përtërihet dhe ne bëhemi më të mirë, për të mësuar gjëra të reja. Gjatë gjumit të thellë forcohen njohuritë, ashtu që në mendjen tonë nguliten më lehtë.



Kompensimi i gjumit

Nëse një natë je i zgjuar tepër vonë, është e lehtë të besohet, se ti ke nevojë të flesh natën tjetër, dyfishin e kohës. Por, kjo nuk qëndron ashtu. Trupi është goxha i aftë të kompensoj gjumin e humbur. Kur ti fle pak, ti e kompenson atë, duke fjetur më thellë.

Pyetje për "Gjumin"

Cilat thënie përputhen, me atë çfarë shkruhet për gjumin në tekst?

Vë një kryq në katror, për Po ose Jo, pas secilës thënie.

- | | Po | Jo |
|---|--------------------------|--------------------------|
| 1. Hulumtuesit e dinë, pse njeriu ka nevojë për gjumë. | ☐ | ☐ |
| 2. Gjatë gjumit të ëndrrave, fle lehtë. | ☐ | ☐ |
| 3. Ne ëndërrojmë, pjesën më të madhe të natës. | ☐ | ☐ |
| 4. Është më lehtë të zgjohesh para gjumit të ëndrrës se sa pas gjumit të ëndrrës. | ☐ | ☐ |

Vazhdo me fjalinë duke vënë kryq në katror për atë përgjigje që ti beson se është e saktë. Ti duhet të vësh vetëm një kryq.

5. Nëse ke fjetur tepër pak, një ose dy net...

- A ☐ A ke nevojë të flesh dyfishin më shumë natën tjetër, për të kompensuar gjumin?
- B ☐ A mund ta kompensoj këtë trupi, duke fjetur më thellë, natën tjetër?
- C ☐ A duhet të shkosh e të biesh të flesh shumë më herët mbrëmjen tjetër, për të kompensuar gjumin e humbur?

Në këtë pyetje përgjigjesh me gojë.

6. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?

Qumështi

Letra lexuesish dërguar një gazete

Në Suedi u jepet dreka të gjithë nxënësve në shkollë dhe shpesh shërbehet qumështi si pije me ushqimin. Kohët e fundit ka filluar të diskutohet nëse më të vërtetë është mirë të pihet qumësht. Këtu mund të lexosh se çfarë mendojnë dy persona të ndryshëm rreth shërbimit të qumështit në shkollë.

1.

Ju jepni fëmijëve të shkollës ujë në vend të qumështit

Qumështi i lopës në shkollë nuk është diçka i natyrshëm. Njeriu është gjallesa e vetme në tokë që e konsumon qumështin e një gjallesë tjetër.

Një studim i madh nga universiteti i Upsalës e që kemi mundur ta lexojmë në gazetën e së mërkurës, i përmbys tërësisht mendimet tona të vjetra dhe jo kritike rreth qumështit të lopës. Hulumtuesit kanë gjetur se konsumimi i lartë i qumështit, ka lidhje me shkurtimin e gjatësisë së jetës dhe me thyerje më të shumta të kockave.

Qumështi i lopës nuk është as i natyrshëm por edhe as i mirë për shëndetin e popullit dhe mjedisin. Andaj, nuk është aspak vonë që t'a heqim qumështin e lopës nga shkollat suedeze dhe në vend të tij t'u mësojmë fëmijëve shprehi të reja për pije, e të cilat janë më të mira për mjedisin: pra që etja të shuhet me ujë.

Anders Svensson

Përfaqësues i shoqatës Ha Ushqim Vegjitarian.

2.

Qumështi nevojitet bashkë me ushqimin në shkollë

Përgjigje letrës së Anders Svensson

Anders Svensson nuk do që fëmijëve t'u jepet qumësht në shkollë. Ne dhe OKB-ja e mendojmë të kundërtën – të gjithë fëmijët e meritojnë të kenë qumësht falas në shkollë.

Qumështi përmban 18 nga 22 lëndët ushqyese, për të cilat ne kemi nevojë çdo ditë dhe kjo jep një siguri sa i përket të ushqyerit të fëmijëve, gjatë një dite në shkollë. Në vendet ku ka mungesë të ushqimit, qumështi në shkollë mund të jetë një burim jetik i të ushqyerit, për shumë fëmijë. Po ashtu, studimet e reja kanë treguar, se dreka në shkollë nuk përmban lëndë të mjaftueshme ushqyese, nëse fëmijëve nuk u jepet edhe qumësht, bashkë me ushqimin.

Hulumtuesja e të ushqyerit Ulla Rosander pranë Shkollës së Lartë në Kristianstad, e ka analizuar ushqimin e shkollës, për sa i përket lëndëve ushqyese, e të cilin e kanë ngrënë fëmijët e moshës 10 vjeçare, në tri shkolla të Suedisë, brenda një jave. Këto shkolla i kishin menytë e njëjta të drekës. Rezultati tregoi, se është shumë e rëndësishme për fëmijët, që të pinë qumësht, bashkë me ushqimin dhe është shtesë e rëndësishme, për ata fëmijë që hanë racione të vogla apo që nuk arrijnë të hanë mjaftueshëm, gjatë pushimit të drekës. Qumështi, në mes të tjerash, nevojitet për të përfituar sasi të mjaftueshme të kalciumit, vitaminës B12 dhe magneziumit. Prandaj, është plotësisht e qartë, se qumështi e ka vendin e vet në shkollë.

Petra Strandberg

Përfaqësuese e Fermerëve të Qumështit të Suedisë.

Pyetje për " Letra lexuesish dërguar një gazete"

Vë një kryq në katrorin e përgjigjes që ti mendon se është e saktë. Ti mund të vësh vetëm një kryq.

1. Pse Strandberg mendon se qumështi është i rëndësishëm për fëmijë të shkollës?

- A ☐ Qumështi bën që fëmijët të hanë më shumë në shkollë.
 B ☐ Qumështi bën që njeriu të jetojë më gjatë.
 C ☐ Qumështi përmban shumë lëndë ushqyese.

2. Pse Svensson mendon se fëmijët e shkollës duhet të pinë ujë në vend të qumështit?

- A ☐ Uji është më i lirë se qumështi.
 B ☐ Uji është më i mirë për mjedisin.
 C ☐ Uji e shuan etjen më mirë.

3. Çka ka treguar hulumtimi, sipas teksteve?

- A ☐ Se ka efekte si pozitive ashtu edhe negative nga pirja e qumështit.
 B ☐ Se ushqimi i shkollës e ka një përmbajtje të lartë të lëndëve ushqyese pa qumësht.
 C ☐ Se konsumimi i lartë i qumështit i përforcon kockat.

4. Pse shkruan Strandberg në gazetë?

- A ☐ Ajo do të sqaroj se përse ajo mendon se Svensson e ka gabim.
 B ☐ Ajo do të sqaroj se përse ajo mendon se uji është i mirë për mjedisin.
 C ☐ Ajo nuk do që fëmijët të hanë më pak ushqim në shkollë.

Cilat thënie përputhen me atë që është shkruar rreth qumështit në këtë tekst?

Vë një kryq në katrorin për Po ose Jo pas secilës thënie.

- | | Po | Jo |
|---|--------------------------|--------------------------|
| 5. Svensson thotë se njeriu jeton më pak nëse pi tepër qumësht. | ☐ | ☐ |
| 6. Svensson dhe Strandberg u referohen hulumtuesve të njëjtë në artikujt e vet. | ☐ | ☐ |
| 7. Hulumtuesit duket se janë dakord rreth ndikimit të qumështit. | ☐ | ☐ |

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë

8. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
 9. Cili nga tekstet të ka bindur ty më së shumti? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Qytetet e botës, në rritje gjithnjë e më të shpejtë

Urbanizimi në botë është duke vazhduar, me një ritëm gjithnjë e më të shpejt. Sipas prognozës së OKB-së pritet, që popullsia nëpër qytete të rritet me gjithsej 2,4 miliardë, deri në vitin 2050. Në mënyrë që të gjithë të kenë vend, qytetet do të zgjerohen me një sipërfaqe që i kundërpërgjigjet sipërfaqes së Indisë.

Gjatë viteve 1900-ta, u shtua popullsia që banonte në qytete, nga 220 milionë në 2,8 miliardë. Sipas OKB-së, në vitin 2008, për herë të parë kanë banuar, më shumë njerëz në qytete dhe qendra banimi sesa në fshatra.


Në vitin 2013, është vlerësuar popullsia qytetare globale në afërsisht 3,6 miliardë njerëz, por sipas prognozave të OKB-së, pritet që kjo të arrijë shifrën afërsisht 5 miliardë, në vitin 2030 dhe të tejkalojë 6 miliardë në 2050. Në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, qysh tani, shumica e popullsisë jeton në qytete dhe qendra banimi, ndërsa Afrika dhe Azia qëndrojnë para një rritje dramatike urbane.

Qytetet në rritje paraqesin edhe problem por edhe mundësi

Qytetet në rritje paraqesin në shumë mënyra një sfidë të madhe, sepse urbanizimi i shpejt shkakton probleme shëndetësore dhe mjedisore. Për shembull, mund të bëhet fjalë për ndotjen e ajërimit dhe mungesën e kushteve sanitare. Njëkohësisht, qytetet e mëdha në rritje ofrojnë për shumë njerëz, mundësi që nuk ekzistojnë në fshatra, si për shembull, më shumë vende të lira pune, kujdes më të mirë shëndetësor dhe mjekësor si dhe mundësi për arsimim.

Fakti se gjithnjë e më shumë njerëz banojnë dendur, bën që nevojat për energji dhe transport të zvogëlohen dhe kjo mund të kontribuojë, që të lehtësohet barra mbi klimën.

Zhvillimi i popullsisë në botë 1916-2012 dhe prognoza 2013-2050



Pyetje për "Qytetet e botës, në rritje gjithnjë e më të shpejtë"

Vë një kryq në katrorin e përgjigjes që ti mendon se është e saktë. Ti mund të vësh vetëm një kryq.

1. Cili është efekti më i madh negativ nga shpërngulja e njerëzve në qytete, sipas tekstit.
A ☐ Mjedisi përkeqësohet në qytete.
B ☐ Qytetet zgjerohen.
C ☐ Nevojat për transport rriten.
2. Sa njerëz përafërisht besohet se do të banojnë në qytete në vitin 2040?
A ☐ Afërsisht 6,4 miliardë
B ☐ Afërsisht 3,6 miliardë
C ☐ Afërsisht 5,6 miliardë
3. Cila është arsyeja më madhe që popullsia e qytetit po rritet, sipas tekstit?
A ☐ Mjedisi është më i mirë në qytete.
B ☐ Kushtet për jetesë janë më të mira në qytete.
C ☐ Lëvizja e njerëzve në qytete është më e lehtë.
4. Si ishte ndarja e popullsisë në mes të qyteteve dhe fshatrave në vitin 1961?
A ☐ Në fshatra banonin afërsisht dyfish më shumë njerëz se në qytete.
B ☐ Më shumë njerëz banonin në qytete se në fshatra.
C ☐ Numri i njerëzve ishte i njëjtë, si në qytete ashtu edhe në fshatra.

Në këto pyetje përgjigjesh me gojë.

5. A mund të tregosh shkurt me fjalët e tua, se për çka flitet në tekst?
6. Në tekst shkruhet se gjithnjë e më shumë njerëz do të banojnë në qytete. Cilat janë anët pozitive sipas teje, që të banohet në qytet në vend të fshatit? A mund të tregosh, si mendon atëherë?

Litteraturförteckning

Aisopos. Den girige. I: *Aisopos' fabler*. Ny översättning av Erik Hedén med illustrationer av Arthur Rackham. 1919. Stockholm: Svenska andelsförlaget. (bearbetad)

Aronsson, Karin & Stellan Ottosson, 1993. Lejonet och räven. I: K. Aronsson & S. Ottosson; illustrationer I-K Eriksson & M. Korotyńska, *Min läsebok Blå rosen*. 2:a uppl. Stockholm: Liber. (bearbetad)

Borgström, Håkan, 2010. Sover kroppen när du sover? I: H. Borgström. 2010. *Kroppens mysterier*. Enskede: Borgströms Förlag. (bearbetad)

Carlberg, Jonas, 2014. Mjölken behövs till skolmaten. *Upsala Nya tidning*. Insändare. Publicerad 2014-11-11. (bearbetad)

En karta över en ö. Kartan och frågorna anpassade från IEA Reading Literacy Study. © 1990. International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA). The Hague: International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA), IEA Secretariat¹.

Harrison, Dick, 2014. Hur länge har vi ätit potatischips? Historiebloggen. *Svenska Dagbladet* <http://blog.svd.se/historia/2014/09/28/hur-lange-har-vi-atit-potatischips/?fromMobile=true> Publicerad 2014-09-28. Hämtad 2014-10-19. (bearbetad)

Moström, Jerker, 2013. Världens städer växer allt snabbare. SCB. Statistiska centralbyrån. <http://www.scb.se/sv/Hitta-statistik/Artiklar/Varldens-stader-vaxer-allt-snabbare/#> Publicerad 2013-10-10. Hämtad 2015-01-08. (utdrag)

Paulsson, Jonas, 2014. Ge barnen havremjolk i stället. *Upsala Nya Tidning*. Insändare. Publicerad 2014-11-04. (bearbetad)

Åström, Karin, 2001. Skorpionen – ett spindeldjur med gadd. I: S. Andersson, K. Åström & S. Rune. *Boken om världen*. Stockholm: Liber. (Utdrag)

Bildförteckning

Lejonet och räven. Eriksson, Inga-Karin, 1993. I: K. Aronsson & S. Ottosson; illustrationer I-K Eriksson & M. Korotyńska, *Min läsebok Blå rosen*. 2. uppl. Stockholm: Liber.

Fotografi på skorpion. Hämtad 2015-06-24
[https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/6/6d/Emperor_scorpion_or_Imperial_scorpion_\(Pandinus_imperator\).jpg](https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/6/6d/Emperor_scorpion_or_Imperial_scorpion_(Pandinus_imperator).jpg)

Fotografi på potatischips. Hämtad 2015-02-03
https://pixabay.com/p-476359/?no_redirect

¹ Att IEAs skrifter, studiematerial och undersökningar med organisationens tillstånd får användas för forsknings- och utbildningsändamål ska inte tolkas som att IEA medverkat i eller godkänt någon del av forskningen, eller rapporteringen kring den, eller de utbildningsprogram vari materialet används.